

Datë 15.10.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Prodhimi i lëndës drusore** (Trajtimin teknik të pyjeve me prerje rigjeneruese dhe shëndetësore)”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
77200000-2 Shërbimet pyjore

VLERA E FONDIT LIMIT: 30.524.356,8 (tridhjetëmilion e pesëqind e njëzet e katërmijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë presje tetë) **Monedha, pa TVSH.**

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise është 308.888,45 (treqind e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë presje dyzet e pesë) euro.

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhën euro sipas Bankës të Shqipërisë datë 14.10.2024 është 98.82 lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”*

Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; perkatesisht në vleren 610.487,13 (gjashtëqind e dhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë presje trembëdhjetë) lekë dhe në monedhën euro sipas kursit të këmbimit datë 14.10.2024 është 6177,76 (gjashtë mijë e njëqind shtatëdhjetë e shtatë presje shtatëdhjetë e gjashtë) euro.

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhën euro sipas Bankes te Shqiperise datë 15.10.2024 është 100.62 leke. *Sigurimi i ofertës të jetë i lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 - Operatori ekonomik duhet të disponojë Licencat si më poshtë vijon:

- Licencën për shërbime profesionale për zbatime dhe projektme me Kod III.7.A “Shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyje dhe/ose kullota” leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit (te vlefshme)

Kjo Licencë garanton eksperiencën dhe profesionalizmin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të pikës 4 të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në nenit 41, pika 4, gërma, (a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku specifikisht përcaktohet:

4.Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

Gjithashtu ky kriter është vendosur në mbështetje të ligjit specifik dhe akteve nënligjore në zbatim të tij respektivisht në Ligjin 57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, i ndryshuar VKM nr.438 datë 08/06/2016”, “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e prodhimeve të tjera pyjore”, si dhe udhëzimit nr.2 datë 03/03/2017 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor, me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”

Në mbështetje të VKM-së Nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuara, “Veprimtaria e nënkategorisë”, kriteri për licencën e leshuar nga QKL me kodin III.7. A është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik që do të ofertojë të jete i pajisur me licencën e mesiperme, e nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit, gje e cila krijon bindjen dhe sigurinë të Autoriteti Kontraktor që ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike për realizimin me sukses të kontratës. Në seksionin “Kategoria III.7. A “Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me pyjet apo kullotat”, nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.7.A”, të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar. Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për të ndërhyrë dhe kryer aktivitet në zonën pyjore. Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Sa më sipër konstatohet se gjatë kryerjes së shërbimit, referuar edhe

parashikimeve të preventivit, paraqitet kryerja e veprimtarisë së transportit të lëndës drusore dhe pastrimit në ekonomi pyjore i cili referuar kuadrit ligjor në fuqi "Për pyjet" duhet te kryhet nga subjekte te licensuara dhe është në përputhje me natyrën e kontratës.

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 , pika 1 , pika 2 si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (a) të nenit 43, Seksioni III të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar: Kërkohet vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, në një vlerë jo më të vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të këtij loti, referuar nenin 43 pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, pasi kjo është një procedurë **e Hapur- mbi kufirin e lartë monetar**, dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ofertues, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjatë 3(tre) viteve të fundit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatorët ekonomik duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara

në nenin 41, pika "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.. Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. *Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar), neni 5, pika "c", sipas afateve të miratuara të kryerjes se pagesave të percaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2021 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit** dhe konkretisht jo më të vogël se vlera: **12.209.742 (dymbëdhjetë milion e dyqind e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e dy) lekë ose 123.555 (njëqind e njëzet e tremijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) Euro** (Kursi i këmbimit referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë me datë 14.10.2024 është 98.82 lek).

Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e

gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga Administratori i Shoqërisë, Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i profesionit Inxhinier Pyjesh për të cilin duhet të paraqesë: Kontrate pune (të vlefshme), Diplomë dhe Çertifikatën e lëshuar nga ministria e Turizmit dhe Mjedisit për shërbime në pyje dhe kullota, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Kriteri wshtw vendosur në mbwshtetje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4(b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të përcaktojë drejtuesin teknik inxhinier pyjesh për kryerjen e shërbimeve i cili ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen shërbimeve pasi ai është përgjegjës për zbatimin e projektit në përputhje me kushtet teknike. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky inxhinieri është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafin teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me shërbimet që kërkohen të realizohen të cilat janë shërbime në fushën e pyjeve. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, si dhe në mbështetje të pikës 4 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit të kontratës.

2.3.3 Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **20 (njëzet) punonjës** për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 (c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së shërbimeve

që kërkohen të prokurohen sic janë transporti i lëndës drusore, ngarkim, shkarkim dhe sistemim dhe stivim procese pune që kryhen me krahe pra me fuqi punëtore është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë fuqi punëtore e vertetuar kjo me vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore si dhe me list pagesat ku të vërtetohet numri mesatar i punonjësve. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në sasinë e lëndës drusore që do të transportohet, ngarkohet, shkarkohet dhe stivohet.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamiona, kapaciteti total mbajtës minimumi 7 ton	në pronësi ose me qera	copë	3
1	Sopata	në pronësi ose me qera	copë	8
2	Organellë ose traktor teknologjik	në pronësi ose me qera	copë	2
3	Motosharrë	në pronësi ose me qera	copë	5

Per kete operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Për mjetet që regjistrohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikaten e pronësise, dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumentet e mesipërme duhet të shoqerohen me kontratën noteriale perkatese të qerave, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fatura tatimore perkatese, ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipërme, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirave noteriale e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të shërbimit.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese", këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4, germa (ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është transporti i lëndës drusore, të dëshmojnë që kanë, makinerit dhe pajisjet e nevojshme të përcaktuara më sipër me qëllim realizimin të objektit të prokurimit. Ndërkohe specifikat e çdo pajisje janë të lidhur ngushtë me specifikat e përshkruara në zërat e shërbimit të kërkuara.

Argumentimi për mosndarjen në lote:

Procedura nuk ndahet ne lote, pasi nuk eshte e nevojshme, procedura e hapur pa lote eshte bazuar ne udhezimet si dhe ne legjislacionin ne fuqi.

Nuk është rasti kur kontrata ndahet në lote, nuk përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, nuk është rasi që vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t'i siguronin ato.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Referuar shërbimit që kërkohet të kryhet, atij prodhimit të lëndës drusore, bazuar në termat e referencës dhe specifikimet teknike të hartuara nga Grupi i punës për Përcaktimin e fondit limit, duke qënë se ato, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për shërbimin objekt prokurimi.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performancë, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termet e references:

-Trajtimi dhe shfrytëzimi i fondit pyjor në ngastrat dhe n/ngastrat e ekonomisë pyjore Vërrin, me qëllim sigurimin e nevojave për ngrohje të shkollave, cerdheve dhe banorëve të Bashkisë Tiranë, rigjenerimin dhe shëndetësimin e pyjeve u mbështet në planin e mbarshtrimit dhe inventarizimit të tyre dhe ka si bazë ngastrat dhe n/ngastrat pyjore. Shfrytëzimi i këtyre ngastrave përmbledh ndërhyrjet dhe trajtimet silvikulturore në moshën e shfrytëzimit dhe ku filiza është e siguar.

-Materiali drusor (dru zjarri të llojit ah) që do prodhohet është caktuar brenda mundësisë vjetore të shfrytëzimit, e të trajtimit të pyjeve, në ngastrat dhe n/ngastrat e parashkruara në planin e mbarshtrimit, në ekonomië pyjore “Vërrin” (Shëngjergj), të miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit D.A.P.K dhe A.P.R miraton projektin Tekniko-Ekonomik me të cilin garanton zhvillimin e qëndrueshëm, efektivitetin ekonomik mirëadministrimit dhe ruajtjen e asortimentit dru zjarri.

-Sasia e shfrytëzimit të druve të zjarrit pavarësisht nga nevoja e banorëve është bërë studimi dhe është caktuar brenda mundësive vjetore shfrytëzimit.

Kjo sasi rezultoi nga studimi dhe inventarizimi i cdo ngastre pyjore për periudhën 20.04.2024 deri 26.06.2024, nga grupi i punës meqënëse kjo ekonomi pyjore ka kaluar afatin e hartimit të planit 10 vjeçar të mbarshtrimit.

Transporti i lëndës drusore do të bëhet mbas markimit me mënyrën dhe ngjyrën përkatëse të miratuar nga A.P.R dhe do shoqërohet me faturë dhe vërtetim transporti, sipas formatit dhe

përmbajtjes së miratuar me urdhër të Ministrisë së Mjedisit. Prodhimi i Vërtetimeve të Transportit, administrimi i tyre do të kryhet nga A.P.R nëpërmjet specialistëve të D.A.P.K.

Dorëzimi i ngastrave pyjore për shfrytëzim të subjektit kontraktuar do të bëhet me pjesë, me Proces-Verbal dorëzimi cdo pjese. Sektori i menaxhimit pranë D.A.P.K. përgjegjës për menaxhimin e pyjeve e kullotave harton proces-verbalin e pastrimit dhe kolaudimit pjesor të ngastrave ose n/ngastrave pyjore.

Deri në momentin e dorëzimit dhe kolaudimit përfundimtar ngastrat pyjore do mbrohen nga prerjet pa kriteret teknike, zjarret dhe dëmtime të tjera nga subjekti Kontraktues.

-Kolaudimi provizor dhe përfundimtar do bëhet nga sektori i A.P.SH.K në prani të drejtuesit teknik të subjektit.Subjekti i Kontraktuar do të zbatojë rregullat dhe kërkesat teknike, metodikat e procedurat e caktuara në projekt, si dhe skemën teknologjike të shfrytëzimit të pyjeve.

D.A.P.K do monitorojë mënyrën e shfrytëzimit nxjerrjen në vendet e caktuara, ngarkimin, transportin dhe dokumentacionin përkatës.Me përfundimin e operacioneve të punës të caktuara subjekti do ja dorëzojë ngastrat dhe n/ngastrat e përshkuara me prerje D.A.P.K sektorit A.P. SH.K shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Në mungesë të planit mbarshimit dhe inventarizimit të pyjeve nga sektori i A.P.SH.K u hartua studimi pjesor për ngastrat dhe n/ngastrat pyjore, 56/a, 56/b, 56/c, 57/58.

Operacionet e punës që do të kryhen nga subjekti janë si më poshtë vijon:

Nr. Operacionit të punës: 37/B-b

I- Emërtimi: Prodhim dru zjarri me motorsharrë.

Nr.Operacionit: Transport dru zjarri me kafshë në distancën 90-100 m

I. Ngarkimi

Nr. i Operacionit - 92

Emërtimi: Ngarkim dru zjarri me krah me automjete duke përfshirë edhe afrimin e tyre në distancë deri 10 m

II. Shkarkimi

Nr. operacionit: 103

Emërtimi: Shkarkim dru zjarri me krahë nga automjetet, duke përfshirë edhe largimin e tyre në distancë deri në 10 m

III. Stivimi

Nr. operacionit: 114

Emertimi: Stivim dru zjarri me krah në pjesë të fiksuara si dhe në vijë lineare në qendër tranzite apo fushat e druve, duke përfshirë edhe afrimin e tyre nga vendi i shkarkimit deri në stivë

IV. Transportin e druve të zjarrit me automjet nga Ekonomia Pyjore “Vërri” në fushën e druve

Distanca e transportit, parcelë - fusha druve (automjet) = 62 Km

Nr. i Operacionit - 76

Emërtimi: Pastrim i parcelave të pyllit ku ndërhyet për herë të pare.

Të dhënat e përgjithshme të parcelave që do të shfrytëzohen:

Ekonomia Pyjore: Vërri

Ngastra: 56/a

Sipërfaqja përgjithshme: 13.25 ha

Sipërfaqja që do shfrytëzohet: 13.25 ha

Lloji Drusor: 10 Ah

Faza e prerjes: Prerje Rigjeneruese dhe Shëndetësore

Intensiteti i ndërhyrjes: 20 %

Forma e qeverimit: Trungishte

Pjerrësia e mesme: 11⁰ - 40⁰

Vëllimi gjithsej i n/ngastrës: 5 356 m³

- Lëndë punimi: m³

- Dru zjarri: m³

Vëllimi i shfrytëzueshëm: m³

- Lëndë punimi: m³

- Dru zjarri: 800 m³

Periudha e shfrytëzimit: (12 muaj)

Tipi i pyllit: I thjeshtë
Mosha: Mbi 80 vjet
Përbërja: 10 Ah
Lartësia mbi nivelin e detit: 1 100 m - 1 300 m

Ekonomia Pyjore: Vërrri
Ngastra: 56/b
Sipërfaqja përgjithshme: 12.75 ha
Sipërfaqja që do shfrytëzohet: 12.75 ha
Lloji Drusor: Ah
Faza e prerjes: Prerje Rigjeneruese dhe Shëndetësore
Intensiteti i ndërhyrjes: 20 %
Forma e qeverimit: Trungishte
Tipi i pyllit: I thjeshtë
Mosha: Mbi 60 vjet
Përbërja: 10 Ah
Lartësia mbi nivelin e detit: 600 m - 800 m

Ekonomia Pyjore: Vërrri
Ngastra: 56/c
Sipërfaqja përgjithshme:
Sipërfaqja që do shfrytëzohet: 16.5 ha
Lloji Drusor: Ah
Faza e prerjes: Prerje Rigjeneruese dhe Shëndetësore
Intensiteti i ndërhyrjes: 20 %
Forma e qeverimit: Trungishte
Tipi i pyllit: I thjeshtë
Mosha: Mbi 110 vjet
Përbërja: 10 Ah
Lartësia mbi nivelin e detit: 600 m - 800 m

Ekonomia Pyjore: Vërrri
Ngastra: 57
Sipërfaqja përgjithshme: 22 ha
Sipërfaqja që do shfrytëzohet: 22 ha
Lloji Drusor: 10 Ah
Faza e prerjes: Prerje Rigjeneruese dhe Shëndetësore
Intensiteti i ndërhyrjes: 20 %
Forma e qeverimit: Trungishte
Tipi i pyllit: I thjeshtë
Mosha: Mbi 100 vjet
Përbërja: 10 Ah
Lartësia mbi nivelin e detit: 100 m - 1 200 m

Ekonomia Pyjore: Vërrri
Ngastra: 58

- Prodhimi: 800 m³
- Transport i brendshëm: 800 m³
Kolaudimi i ngastrës: në 25.12.2025
Transport i largët: 62 km

Pjerrësia e mesme: 41⁰ - 70⁰
Vëllimi gjithsej i n/ngastrës: 9 314 m³
- Lëndë punimi: m³
- Dru zjarri: m³
Vëllimi i shfrytëzueshëm: 1 100 m³
- Lëndë punimi: m³
- Dru zjarri: 1 100 m³
Periudha e shfrytëzimit: (12 muaj)
- Prodhimi: 1 100 m³
- Transport i brendshëm: 1 100 m³
Kolaudimi i ngastrës: në 25.12.2025
Transport i largët: 62 km

Pjerrësia e mesme: 40⁰ - 50⁰
Vëllimi gjithsej i n/ngastrës: 4 553 m³
- Lëndë punimi: m³
- Dru zjarri: m³
Vëllimi i shfrytëzueshëm: 721 m³
- Lëndë punimi: m³
- Dru zjarri: 721 m³
Periudha e shfrytëzimit: (12 muaj)
- Prodhimi: 721 m³
- Transport i brendshëm: 721 m³
Kolaudimi i ngastrës: në 25.12.2025
Transport i largët: 62 km

Pjerrësia e mesme: 11⁰ - 40⁰
Vëllimi gjithsej i n/ngastrës: 9 460 m³
- Lëndë punimi: m³
- Dru zjarri: m³
Vëllimi i shfrytëzueshëm: 1 050 m³
- Lëndë punimi: m³
- Dru zjarri: 1 050 m³
Periudha e shfrytëzimit: (12 muaj)
- Prodhimi: 1 050 m³
- Transport i brendshëm: 1 050 m³
Kolaudimi i ngastrës: në 25.12.2025
Transport i largët: 62 km

Pjerrësia e mesme: 41⁰ - 70⁰
Vëllimi gjithsej i n/ngastrës: 15 177 m³

Sipërfaqja përgjithshme: 58 ha

Sipërfaqja që do shfrytëzohet: 52 ha

Lloji Drusor: Ah

Faza e prerjes: Prerje Rigjeneruese dhe Shëndetësore

Intensiteti i ndërhyrjes: 20 %

Forma e qeverimit: Trungishte

Tipi i pyllit: I thjeshtë

Mosha: Mbi 100 vjet

Përbërja: 10 Ah

Lartësia mbi nivelin e detit: 800 m - 1 100 m

- Lëndë punimi: m³

- Dru zjarri: m³

Vëllimi i shfrytëzueshëm: 1 750 m³

- Lëndë punimi: m³

- Dru zjarri: 1 750 m³

Periudha e shfrytëzimit: (12 muaj)

- Prodhimi: 1 750 m³

- Transport i brendshëm: 1 750 m³

Kolaudimi i ngastrës: në 25.12.2025

Transport i largët: 62 km